



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	18/06/2014
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK- DPKPP
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Abaz FONIQI Shef i Zyrës së Prokurimit - Komuna e Klinës
<b>CC:</b>	z. Sokol BASHOTA Kryetar – Komuna e Klinës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan PRETANI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me tenderin: “Asfaltimi i rrugëve në Qytet – Faza 2”

I nderuari z. FONIQI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Asfaltimi i rrugëve në Qytet – Faza 2” me numër të prokurimit: 634-14-049-521, Agjencia Kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Asfaltimi i rrugëve në Qytet – Faza 2” me numër të prokurimit: 634-14-049-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Komuna e Klinës, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Asfaltimi i rrugëve në Qytet – Faza 2” me numër të prokurimit: 634-14-049-521. Ky aktivitet prokurimi më datë: 02/06/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në “Njoftim për Kontratë” pika III.2 KUSHTET PËR PJESEMARRJE, nënpika III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë, kërkohet: Regjistri i biznesit me numër fiskal dhe pagesa e taksave, ndërsa në “Dëshmia e kërkuar dokumentare” Certifikata e TVSH-së. Pra, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar në këtë rast certifikatë të TVSH-së, ndërsa ka kërkuar të dëshmohet. Kërkohet të dëshmohet diçka që nuk është kërkuar paraprakisht.

Në “Njoftim për Kontratë” pika III.2 KUSHTET PËR PJESEMARRJE, nënpika III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar tek dëshmia kërkohet: Raporti i bankës në periudhën e kaluar 2013, apo raport Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2013. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar a auditivitet me reputacion, nuk mjafton vetëm formulimi raport Auditimi, sepse nuk mund të pranohet raporti të cilin mund ta ketë bërë një Auditor edhe nëse ai është i licencuar. Gjithashtu, Komuna e Klinës si Autoritet Kontraktues është dashur të referohet në tre vitet e fundit, e jo vetëm në vitin paraprak.

Në “Njoftim për Kontratë” pika III.2 KUSHTET PËR PJESEMARRJE, nënpika III.2.4, Kapaciteti teknik dhe profesional kërkohet: Deklarata për garantim të cilësisë – obligative. Autoriteti kontraktues mund ti referohet certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse. Autoriteti Kontraktues, nuk mund të merr për dëshmi të cilësisë vetëm deklaratën nga Operatori Ekonomik ofertues.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Pika 23 Kriteret e Përzgjedhjes i Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje të këtij aktiviteti të prokurimit dhe shmangien e praktikave të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

